



**VENDIM**

**Nr.102, Datë 23.06.2016**

**PËR  
MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË OST SH.A. LIDHUR ME  
MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E TRANSMETIMIT,  
SHËRBIMET NDIHMËSE DHE DISBALANCAT**

Në mbështetje të neneve 1; 16 dhe 62 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.”; Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, Miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 68, datë 23.06.2008 dhe nenit 26 të Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.06.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me miratimin e “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik ”,

**Konstatohet se :**

- Marrëveshja e miratuar me vendimin nr. 79 date 07.06.2016 “Për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a”, i shtrin efektet e saj deri më 30 qershor 2016.
- Neni 62 i Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” parashikon se: *Operatori i Sistemit të Transmetimit prokuron energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjet, shërbimet e balancimit ose ato ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit, nëpërmjet një procedure konkurruese, jodiskriminuese dhe transparente.*
  - a. *Procedurat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, miratohen nga ERE pas propozimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.*
- **Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të sigurojë energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjet, shërbimet e balancimit dhe ato ndihmëse me anë të kontratave**

*bilaterale të miratuara nga ERE për një **periudhë jo më të gjatë se 12 muaj** nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.*

- Aktualisht ne tregun shqiptar të energjisë vetëm njesite gjeneruese të të licensuarit KESH sh.a. mund të shërbejnë për sigurimin e shërbimeve ndihmese.
- Koha për kryerjen e procedurave të prokurimit për muajin korrik të humbjeve në rrjetin e transmetimit është shumë e shkurtër.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

### **Vendosi:**

1. Të miratojë kërkesën e OST sh.a për të lidhur kontratë bilaterale me pjesëtarin e tregut KESH sh.a për të siguruar shërbimet ndihmese dhe balancimit për periudhën e mbetur të vitit 2016.
2. Për qëllime të prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit për muajin korrik 2016, OST të sigurojë humbjet nga KESH sh.a. me çmimin mesatar të bursës hungareze HUPEX për energjinë elektrike të levruar nga KESH sh.a. për qëllime të mbulimit të humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit sic publikohet në ueb-site-in e kësaj burse (ëëë.hupeh.hu).
3. Deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të Rregullave të blerjes së energjisë elektrike sipas ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", OST sh.a. të prokurojë energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit në përputhje me *Rregulloren procedurave të blerjes nga Kesh sh.a, së energjisë elektrike, nga tregtarët vendas dhe të huaj miratuar me Vendimin Nr. 30 Datë 23.03.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE.*
4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERJISË**  
Bordi



---

Votimi i Bordit të ERE-s për,

**VENDIM**

*Nr.102, Datë 23.06.2016*

**PËR  
MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË OST SH.A. LIDHUR ME  
MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E TRANSMETIMIT,  
SHËRBIMET NDIHMËSE DHE DISBALANCAT**

Anëtarët e Bordit

	<b>Pro</b>	<b>Kundër</b>
<b>Petrit Ahmeti</b>	_____	_____
<b>Adriatik Bego</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Maksim Shuli</b>	_____	_____